

VENDIM
Nr. 374, datë 11.6.2014

**PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI,
TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË**

(ndryshuar me VKM nr. 954, datë 29.12.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet kundërparti të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave, në shumën 130 517 500 (njëqind e tridhjetë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, të trajtohen si të ardhura jashtë limiti dhe të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit brenda muajit mars të vitit 2015.

2. Këto fonde të përdoren nga AZHBR-ja në formën e huas pa interes, me qëllim nxitjen, rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral dhe përpunimin e këtyre produkteve.

3. AZHBR-ja mund të realizojë disa herë, brenda muajit mars të vitit 2015, procedurën e pranimit dhe të vlerësimit të aplikimeve, deri në përdorimin e plotë të fondeve.

4. Vlerat monetare që do të përdoren për mbështetjen e zhvillimit bujqësor dhe blegtoral të jenë në përpjesëtim me masën e investimit të vetë përfituesit.

5. Me këto fonde të financohen investimet për:

a) ndërtim/rikonstruksion të stallave, pularive apo modernizim të komplekseve blegtorale dhe instalim të impianteve të tyre ndihmëse;

b) ndërtim/rikonstruksion (përfshirë edhe serra), blerje dhe instalim të linjave për ruajtje, përpunim dhe ambalazhim të produkteve bujqësore, blegtorale.

6. Masa e financimit për këto investime të jetë në varësi të llojit dhe të vlerës së vetë investimit, përkatësisht:

a) Për ndërtim/rikonstruksion të stallave, pularive apo modernizim të komplekseve blegtorale dhe instalim të impianteve të tyre ndihmëse, deri në 70% të vlerës së përlogaritur të investimit, por jo më shumë se 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë;

b) Për ndërtim/rikonstruksion (përfshirë edhe serrat), blerje dhe instalim të linjave për ruajtje, përpunim dhe ambalazhim të produkteve bujqësore e blegtorale, deri në 80% të vlerës së përlogaritur të investimit, por jo më shumë se 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë.

7. Vlerat monetare të lëvuara për të mbështetur zhvillimin e investimeve të sipërpërmendura në formën e huas pa interes, të jenë me maturim 7 (shtatë)-vjeçar.

8. Procedurat, kriteret e përfitimit të huas, shlyerjes së detyrimeve dhe mënyra e administrimit të fondit të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Financave.

9. Kriteret e vlerësimit dhe pikëzimit përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

10. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama